



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:209727
Datë: 06.03.2024
Numri i dokumentit: 05419510

PPP.nr.212/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, rr “Armend Dac”, nr.1, kundër debitorit Rr.Rr. nga fsh ..., Komuna e Shtimes, për pagesën e gjobës administrative, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Rr.Rr., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit P.nr.544/2022, i datës 22.09.2022, i lëshuar nga përbaruesi privat B.A. nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përbarimit P.nr.544/2022, i datës 22.09.2022.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.544/2022, të datës 22.09.2022, përbaruesi privat B.A., e ka caktuar përbarimin e propozuar nga kreditor Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Rr.Rr., për pagesën e gjobës administrative në shumë prej 6,179.86 euro, në bazë të aktvendimit nr.4918, të datës 26.11.2020, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përbarimore, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përbaruesit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhrin për përmbarim.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim P.nr.544/2022, i datës 22.09.2022.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se përveç shqiptimit të gjobës, inspektorati i KPMM ka iniciuar edhe procedurë penale kundër Rr.Rr. përmes Prokurorisë Themelore në Ferizaj, me pretendimet se kishte kryer veprën penale, ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338, par 1, i KPRK-së. Kjo akuzë kundër të njëjtit nuk u vërtetua me asnjë provë të vetme si nga organi ndjekës po ashtu edhe nga pala e dëmtuar, ku pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore, Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni penal, mori aktgjykim lirues dhe përkundër aktgjykimit lirues, kreditori, komisioni i shkallës së dytë, merr vendim me datën 11.01.2022 duke e refuzuar ankesën e debitorit dhe e lë në fuqi aktvendimin me anë të cilit shqipton gjobën prej 6,179.86 euro, gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesën e kreditorit për përmbarimin e një aktvendimi mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj debitorit por jo edhe të procedurës penale, sepse procedura penale është një procedurë e veçante nga ajo administrative në të cilën është nxjerrë aktvendimi nr.4918, i datës 26.11.2020, në bazë të cilit është nxjerrë urdhri i atakuar me prapësim nga debitori. Për më tepër fakti që debitori është liruar nga akuza për veprën penale që lidhet me ndotjen, degradimin ose shkatërrimin e mjedisit nga neni 338, par 1, të KPRK-së, nuk nënkupton se gjoba e shqiptuar në procedurën administrative nga kreditori ka pushuar së ekzistuar apo se ekziston ndonjë pengesë në ekzekutimin e saj, për faktin se siç vërtetohet nga aktvendimi mbi shqiptimin e gjobës, debitorit i është shqiptuar gjoba për shkak të mungesës së licencës për shfrytëzimin ose eksploatimin e burimeve minerale në Kosovë dhe nuk mund të merret parasysh fakti që debitori është liruar nga akuza për veprën penale të cekur më lart me gjobën e shqiptuar administrative në fjalë.

Gjithashtu, sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se aktvendimi mbi gjobën administrative nuk është në përputhshmëri me normat ligjore, ngase në mënyrë arbitrare inspektorati në fjalë ka gjobitur Rr.Rr. por edhe në shkelje të procedurës administrative ka marr

vendim për vërtetimin e aktvendimit të atakuar, gjykata edhe këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse gjatë vendosjes lidhur me prapësimin e debitorit, nuk ka të drejtë dhe kompetencë ta bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së nxjerrjes së aktvendimit në bazë të cilit është nxjerrë urdhri për përbarim sepse një gjë e tillë siç konstatohet nga vendimi i shkallës së dytë të kreditorit i datës 11.01.2022.

Për më tepër, aktvendimi mbi shqiptimin e gjobës nr.4918, i datës 26.11.2020, në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.2, të LPP-së, konsiderohet dokument përbarimor në bazë të cilit mund të caktohet përbarimi. Po ashtu, aktvendimi i cekur është i përshtatshëm për përbarim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, dhe të nenit 36, par 1, të LPP-së, për arsye se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit, si dhe aktvendimi në fjalë është i pajisur edhe me klauzolën përbarueshmërisë për përbarueshmëri, respektivisht është i formës së prerë nga data 15.01.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 31.01.2022.

Gjithashtu, gjykata konstaton se propozimi për përbarim i kreditorit është në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 38, par 1, të LPP-së, respektivisht propozimi për përbarim i kreditorit siç shihet e përmban kërkesën për përbarim, dokumentin përbarimor në origjinal, kërkuar e përbarimit dhe të dhënat e debitorit, duke e përfshirë edhe numrin personal të letërnjoftimit të debitorit, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit.

Si përfundim, duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, thëniet e kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, si dhe duke i marr parasysh provat dhe shkresat tjera të lëndës, Gjukata konstaton se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përbarim P.nr.544/2022, i datës 22.09.2022, të mbetet në fuqi.

Andaj, Gjukata bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.212/22, më datë 06.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.